



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:306337

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06919042

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në lëndën penale kundër të pandehurit B.K. me numër të letërnjoftimit ... për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par 1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1789/2024, të datës 31.10.2024, si dhe bazuar në nenin 15 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim më datë 28.02.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

- 1. APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit** në lëndën **P.nr.335/2024** dhe me numër të marrëveshjes **ND: 34/2025**, e arritur me datën 27.02.2025 e pranuar nga gjyqtari me datë 28.02.2025, për të pandehurin e cekur si në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi.
- Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
- Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse dhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
- Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2024:306337, 28.02.2025**

**Gj y q t a r i
Agron Maxhuni**